

Hamza Koçiu

Erdhën
djemtë
nga
ushtria

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1

K 77

vjersha

891.983-1

K 27

S

HAMZA KOÇIU

ERDHËN DJEMTË NGA USHTRIA

V J E R S H A

~~52582~~ 13051

BIBLIOTEKA E SHËTETIT
GJIROKASTER

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Kopertina nga: **Svetlana Strazimiri**
Redaktor: **Adriatik Kallulli**

RAPSODI AKSIONESH

Ditë të reja, mbrëmje të reja,
ikin beteja, vijnë beteja;
ngrehim epokat në pedestal,
dritë e Partisë shkëlqen kristal.
Mbi supe njerëzish çelur burbuqe,
shami aksioni, ngjyra të kuqe,
sfonde tarracash mbi mal shaluar,
qielli i kaltërt, dielli i gëzuar...
Buzë çentralesh takojmë ylberë,
shkon një pranverë, vjen një pranverë,
rapsodi hovesht shpërthen guximi,
rrjedh djersë e punës si lot gëzimi.
Shket buzë dritash viti shtatëdhjetë,
shket buzë agimesht kënga trumbetë,

buçet sot lodra, gjëmon gërneta
dorën s'e heqim nga bajoneta.
Mban Shqipëria krahët të ngritur,
në komunizëm shkon ballëndritur.

LULET

Lule!

Në tokën time të bukura keni mbirë,
më prekni me petale dhe burbuqe,
më derdhni në zemër aromën më të mirë,
shkëlqeni dhe shkëlqeni si flakë të kuqe.
Ju ledhatoj me dorë, siç ledhatoj një fëmijë,
ju puth ëmbël pranë një lapidari,
ashtu siç puth në faqe time bijë,
lule të kuqe, të bardha, ngjyrë ari.

Lule!

Mbi gjurmat tona dhe shpata malesh keni
mbirë,
dhe mbini ju, lule, pranë gëzimeve tona:
buzë muzgjesh e dritash të bukura mbini,

dhe çelni në sfondin të kuq banderolash,
tribunave festive flakërimi.

Lule, të bukura si zemrat rinore,
të çelura si ëndrrat dhe dashuria,
ngjyrat dhe petalet tuaja i mbolla
në kopshtet e strofave të mia;
ju mbolla në kantiere te punëtorët,
ju kam rritur në sheshe fabrikash
lule të kuqe, porsia yje të kuq,
lule të bukura që ju dua kaq shumë.

BIRI IM

Biri im, djali im i mirë,
cili mur i viteve na ndan?
Ti ke lindur në maternitet,
unë bri një mali të një stani.

Mua çobenjtë me gunë më pështollën
dhe më rriti pushka edhe guna,
kur në gjoks të viteve vërshëllenin
aeroplanë, bomba dhe plumba.

Biri im, gjak i gjakut tim,
cila rrugë e madhe na bashkon?
Gjithë shkëlqimi i rrugës socialiste
në ndërgjegjen tonë flakëron.

TË GJITHA...

Mbi supin tim le të rëndojnë të gjitha:
Atdheu, këngët, dashuria,
buka dhe taracat përmbi male,
qumështi i deles, që spërkati vjershat e mia.
Flatrat e gëzimeve le të rëndojnë mbi mua
fushat dhe uzinat në mesnatë.
Ëndrrat e çelura në udhën e gjatë.

TË KATËR

Kur grykën e tij e pikasën
nga derdheshin plumbat e nxehtë,
sërishmi u ngritën të katër,
u hodhën në sulm të rreptë.
Bunkeri qëllonte me zjarr:
«Granatat mbi të!» tha i pari,
por krisma e hekurt s'u ndal,
një plumb ushtarin e ndali...
«Të marrim patjetër bunkerin,
për shokun betohemi ne,
granatën në gojë t'ja hedhim,
flamurin ta ngremë atje».
Dhe brofën të tre njëherësh:
i pari si shqipe u sul,
i dyti me flamur në dorë,

i treti këceu përmbi kullë;
të tre mbi bunker u ngjitën:
i pari me plagë në krah,
i dyti flamurin e ngriti,
i treti shpërtheu në urra!

ERDHËN DJEMTË NGA USHTRIA

Erdhi vjeshta, erdhën dhe ushtarët,
nga ushtria bijtë u liruan;
pyet fshati, pyesin fshatarët:
— Po zanate vallë a mësuan?

Buçet gajdja dhe zogjtë këndojnë,
hiqet vallja, vjeshta fletët shkund:
— Sa gëzim kur bijtë na nderojnë,
me zanate kthehen në katund.

Mblidhet fshati, zien kuvendi i zjarhtë,
flasin bijtë, ndizen dhe dëshirat
për zanatet, marshimet e gjata,
për stërvitjet, qitjet e vështira.

Flasin bijtë, flasin shumë thjesht.
I dëgjon me ëndje gjithë katundi:
vjeshtë e artë shkul nga degët fletët,
pleqtë mykun nga supi e shkundin

USHTAR

Ushtari sheh si fletët fëshfërijnë,
ushtari sheh dhe barin e kosit,
porsi ky bar armiqtë do kositë
alarmit kur ta ftojnë gjith' buritë,

kur zogjtë të cijasin: vrap, ushtar,
kur nëna të thërresë «sulu, bir,
kur motra të buçasë «zjarr, vëlla,
kur toka të gjëmojë: «përmbi ta!

Ushtari synë e ka te gryk' e pushkës,
ushtari di të rrojë dhe me gjeth;

ushtari ujë pi te gjurm' e mushkës,
ushtari të vështirën udhë zgjedh;

ushtari në tabelë fut çdo plumb,
kudo zbardh çadra e tija si kërpudhë!
Marshimi i ushtarit nuk ka fund,
në gjoks të këtij vendi puth çdo rrudhë.

TË GJITHA RRUGËT MË SJELLIN TEK TI

Nënës sime N. K.

Ti më zgjat duart, më puth me mall ndër sy.
Unë të shoh rrudhat si ballin të kanë zënë,
unë të shoh flokët të bardha shkumëdeti.
Kur më përcjell, krenare qëndron ti.
Kujtimin tënd i heshtur e marr me vete,
kujtimin tënd dhe tënden dashuri!
Kujtimet marr dhe puthjen tënde marr.
Ti djem i ke gjithë bijtë e kësaj toke
dhe nuk harroj se jam për jetë ushtar
unë biri yt, nënoke.
Shumë pak ti fle
dhe natën shqetësohesh.

Pagjumësia jote pas më ndjek.
Në roje rri, mbi maja lartësohem,
më ngjan sikur me dorë ti më prek.
O nëna ime,

gëzimi yt i dhembshur
më ledhaton dhe rrugës në marshim
gëzimi yt

alarmeve të zgjatur
si rreze drite hyn në shpirtin tim.
Dhe larg, dhe afër, kudo që jam,
të gjitha rrugët më sjellin tek ti!

DHE NË DET I KA SHQIPET REPUBLIKA

Ngjatjeta breg, mes kaltërsisë së madhe
anija rend, flamuri qiellin rreh,
merr frymë deti, era ngre stërkala.
Detari grykën topit lart i ngreh.

Ngjatjeta breg, në detin e pamasë
mëngjezi i kuq si hark shkëlqimi zbret,
më përshëndet me dorë vendi i dashur
dhe dora e tij në gjoksin tim troket.

~~57522~~
13051

BIBLIOTEKA E SHËTETIT
GJIROKASTER

Ç'PASHË SOT TE USHTARËT

Ç'pashë, vëllezër, sot te ushtarët,
Ç'pashë në sytë e tyre të qartë?
Mos thoni, shokë, se unë pashë
yje të zbritur nga lart.

Pashë në zemër të tyre të re
besimin e qartë si zjarr i pashuar,
pashë në sytë e tyre vigjilencën
dhe reportazhin tim të gëzuar.

M O T R A

Sytë e motrës sikur bisedojnë,
sytë e motrës sikur vizatojnë
pushkët që motrat shtrëngojnë pranë,
baltën që motrat në shtigje çanë.

Motra kish veshur këpucë të rënda...
Në tri marshime të rënda ju bënë,
në tri marshime, tri sulme të zjarrita;
tri shira të ftohta, tri net pa hënë.

Motrat pat ndenjor tri net pa gjumë
tri net pa gjumë-motra ushtare,
po shkëmb qëndroi në llogore
e vrau e vrau me batare.

KRITIKË PËR SHOKUN ALIKO

Aliko, Aliko, ti nuk fjete mbrëmë,
edhe pse të rrinte gjumi në qerpikë,
gjumi të rëndonte si hekur i rëndë,
gjumin ta largonte ty një «dreq» kritikë;
të thumboi kritika, të preku si grerë.
Aliko, çfarë ndjeve në atë pickim?
Shokët në stërvitje ty të thanë prerë:
«Komandanti ynë sot e ke gabim».
Ç'bëre në stërvitje, ç'bëre në taktikë?
Teatri që zgjodhe nuk shkonte aspak;
kodra nuk të ruante, në atë vendmbrojtje,
«Armiku» të digjte, të lante në gjak.
Shokët ty të thanë: «Te ky vend i vdekur»,
nuk hedh dot një pushkë, s'hedh dot një
granatë.

Të zgjedhim llogoret, armikut t'i duken:
Llogoret si male, llogoret si natë.
Aliko, ç'u nxehe, the: kështu do bëhet.
Urdhërin zbatuan shokët atë ditë.
Stërvitja shkoi keq. Të dukej, Aliko,
sikur ajër s'kishe, sikur s'kishe dritë.
Aliko, Aliko, vallë ç'do të ngjiste,
dhe me çfarë do blehej kjo në një luftim?
Në flakë të luftës zemra do të dhembte
zemra do të ndillte helm e pikëllim.
Kur të kritikuan, në heshtje u mbylle.
Gabimi të ziente përbrenda si det.
Ndëshkimi i rëndë të shfaqej përpara;
dhe si me shuplakë ballin ta goditte.
Buzët, o Aliko, për një çast t'u drodhën
për një çast, Aliko, koka t'u mbush thinjë.
Për një çast të shfaqej lufta partizane
dhe ndjeve një therje si thikë në brinjë.
Në luftë, Aliko, gabimet nuk falen
as për komandantët, as për një ushtar;
gjykoje, Aliko, rreptë veten tënde
gjykoje me zemër, gjykoje me zjarr!

EJ, MOJ FATO

Ej moj Fato, nënë plakë,
u bëre si djalë,
pushkën hedhur krahëqafë
u ngjite mbi mal.

Yllin vure në bustinë,
shkele mbi acar.
Vajzat qeshën edhe thanë:
plaka është si zjarr.

Eh moj Fato, nënë plakë,
s'ndenje në shtëpi,

këtu malet ndizen flakë,
këtu erdhe ti.

Vajzat thanë: «Shko, moj nënë,
shko në fshat na prit,
bëna drekë, bëna darkë,
miell gruri sit.»

Vajzat thanë: «Po bën ftohtë,
shko, moj gjyshe e mirë,
përkëdheli çiliminjtë,
ngrohtë, zemërdlirë».

«Pleqëria s'ma dredh dorën,
gjak në zëmër kam:
pleqëria s'ma ngrin gjakun
jam në istikam.

Jam me ju këtu në çetë,
jam sot në stërvitje;
krisma malet le të ndjekë,
kur të bëjmë qitje.

Kënga udhët le të ndjekë,
çukat të kaptojë,
Ostrovicës nëpër kreshta
flokët t'i lëmojë.

Dhe nuk iki, vajza moj,
nënë jam në botë
sot e lumtur vigjëloj,
veshur me kapotë.

Që të rritet, vajza moj,
beregët shtatgjatë,
porsi burrat, armët ngjeshur
t'i mbajmë ne gratë.

Dhe nuk iki, vajza moj,
jam sot një ushtare,
foshnjat ëmbël i lëmoj,
ashpër shkreh batare,

që kallinj të lëshojnë
grunjat sa më shumë,
që në magje, vajza moj,
plot të kemi brumë.

Ju mësoni, vajza moj,
radio, aeroplanë,
vajzëria ime shkoi
heshtur mbi murlanë.

Ju mësoni, vajzë moj,
ju ngroh dashuria;
thellë në kullë më kaloi
mbyllur vajzëria.

Nuk do iki, vajza moj,
edhe pse jam plakë.
Thinjur jam si këta male,
shpirtin e kam flakë.

Vajzat thanë: «Rri, moj nënë,
rri me ne në lojë,
Ostrovica këngën tonë
shpesh do ta këndojë!»

DËSHMORIT BAKI DUME

Kur emrin tënd e vendosëm në pllakë,
ndriçuan mijëra yje si mijëra zjarre;
shkëlqeu përjetësisht e kuqja flakë
e luftës çlirimtare;

ndriçuan gjurmët e tua të gjata
thellë shtigjeve të mbështjella me re dhe
tufane

dhe çelën trëndafilë të zjarrtë
të luftës partizane.

Dhe ne nuk qamë,
kokën lart e ngritëm

krenarinë ta skalitëm në ballë,
trimërinë e Çeços dhe të Selamit
në gjoksin tënd pamë të gjallë.

Dhe ne nuk folëm.
Fjalët në buzë na ngrinë,
po u ndjenë krismat e pushkës mbi shkëmb
dhe suferinë:
na ngjau sikur foli historia.

**SHKUAM TË KORRNIM GRURË
ME FSHATARËT**

Shkuam të korrnim grurë me fshatarët,
shkuam të hidhnim valle me fshatarët,
shkuam të ndiznim drita me fshatarët.
Fshatarët thanë: «Na erdhën ushtarët!
Mirëse të vijnë mes gëzimit tonë,
Këngët i kemi, bashkë të këndojmë,
bukën e kemi, në sofër të hamë,
dritën e kemi, zemrat na ndriçojnë,
le të hyjnë mes gëzimit tonë.
Muskujt i kanë të fortë ushtarët
dhe le të korrin grurin kallizjarrtë;
janë mësuar me punë ushtarët,
nuk i lodh shokët as marshimi i gjatë...
Shkuam dhe korrëm grurin me fshatarët,
bukë na dhanë — zemrat plot gëzim
dhe përshëndetjet morëm nga fshatarët
si këngët ushtarake në marshim!

KËNGË PËR SELIM HASANIN

Që nga kulmi i malit,
thellë gjer në det,
kënga labe ngjitet,
kënga labe zbret.
O moj labja Vlorë,
djem nga kocka jote
kockëfortë rrite.
Këndon xha Selimi
një këngë komite. . .
Mor vëllezër lebër,
ç'i mbulon blerimi
shokët e përgjakur,
këndon xha Selimi.
Ç'i këndon Selimit
shpirt i ndezur shpuzë,

kënga labe ecën
nga buza në buzë.
Këngë e xha Selimit
shpirt e gjak lirie,
o moj kënga labe.
krismë labërie!

KUVENDOJ ME NËNËN

Ti sot po kuvendon me veten tënde
dhe sytë të shkëlqejnë porsi diell,
a mos ke vajtur prapë në ato vende,
ku kemi korrur, dikur, një shoshë miell?
A mos ke vajtur dhe të kujtohet, nënë,
si ecnim zbathur mbi plisat gurëtharë,
dhe flet: «Im bir këtej kaloi pa ngrënë,
këtej më ndoqi duke qarë;
më ndoqi biri ndër shtigje si një manar,
duke lëmuar në dorë misërnike»
dhe hesht ti, nënë, dhe unë kujtoj me zjarr,
gjithë femininë, gjithë ato vite.
Prapë flet ti, nënë, e kush të dëgjon vallë,
mos ai dimër, ajo ngricë, ai tufan,
kur birin tënd e puthe ti në ballë,

kur birin tënd përcolle partizan?
Dhe të kujtohet si tokën e bashkuam,
si çeli në arë krejt një pamje tjetër,
si djersën derdhëm kur thamë ne kënetën,
dhe mbjellim grurë, panxhar, misër e
thekër?

Po ti s'çudite kur flas kështu, moj nënë,
tani që ti Marksini mirë e njeh
dhe prapë flet: Ky komunist ka qenë,
dhe si baba po kuvendon me ne.
Me ne, moj nënë, për jetë ai erdhi,
dhe si baba dhe si gjeni i madh
që arave të çelë më mirë mëngjezi;
mëngjezi i bukur në rrugën tonë zbardh.

PEISAZH VJESHTE

Erdhi vjeshta, erdhi përsëri,
të kafshon kjo erë, gjithkund bie shi,
përmbi shelgje zogjtë cijasin të mardhur,
leshtrat e Gramozit bora i ka zbardhur.

Matanë dritares sodit një çunak
lejlekët, që zhduken qiellit me vrap,
traktorin që çaka brazdat nëpër arë,
buzë piramidës ëmbël sheh ushtarë.

Mjegulla po zbret fushës porsì mugë,
pemëve gjethet u pikojnë çurkë,
në livadhe, tutje sërish zverdhet bari,

hëna midis reve ndrit me ngjyra ari.
Telave mbi shtylla u këndon veriu,
majës së Gramozit bor' e parë ngriu!

QË NGA KOHËRAT ZËRA LUFTË VIJNË

Ç'po fluturoka si zog historia
e toka porsi zog sillet përreth,
nipat lexojnë ç'ishte Shqipëria,
gjyshët kujtimi i largët i rrënqeth.
Nipat lexojnë dhjetëra historira
gjyshët këndojnë historinë e re
si erdhën Mujët, Gjergj Elez Alia,
si çanë shtigjet gjer tek ne.
Gjyshët e kanë në ballë historinë,
nipat e mbajnë pushkën mbi traktor
dhe që nga kohërat zëra lufte vijnë
mbi vendin tim, që ngrihet madhështor.

MONOLOGU I NJE ZEZAKU

Unë dua të jetoj i lirë, xhelat,
dhe nuk dua të vdes.

Tokën dhe qiellin tim kam përqaftuar,
tokën dhe qiellin tim që m'i ke pushtuar.
Më dhimbsen xhunglat dhe palma që
bleron, . .

Porsi një bishë na vjen në vatra,
na prish qytete, zëmrat na copëton.

I bardhë je, zemërzi, xhelat.

Unë do të të vras kudo pa mëshirë.
Për trupin tënd nuk do të ketë varr.
Ne nuk kemi vdekur, xhelat,
rrojmë nën palma dhe bambutë,
rrojmë nëpër xhungla.

Trupin na e ngroh dielli i nxehtë,

këmbët na i lëmon rëra e butë.
Ti më qëlllove
kur shumë vrava nga ju me batare.
Unë dua të jetoj i lirë, xhelat,
dhe nuk dua të vdes.

LETËR TATËS

O tata im, të shkruaj këtë letër. . .
Çudi mos të të vijë aspak, aspak. . .
Tani që unë e prisha atë fejesë,
më ngjan se linda prapë aty mbi prak.
E di, kjo letër tepër do të prekë,
do të thuash ti: «Nuk ka më burrëri.
Më mirë, o cucë, atje të kishe vdekë,
më mir' të t'kish varros' ky turp i zi».
O tata im!

Ky turp do të rëndojë
si bjeshkët përmbi krye, si një mal,
si thikë shpirtin tënd do ta shpojë
dhe unë e di: lehtë nuk më fal.
Kur linda unë, sa u dëshpërove
e prifti më pagëzoi me hidhërim

dhe që në djep, atëhere, më fejove
dhe që në djep burgose shpirtin tim.
Atë ditë që më fejove, u qetësove!
Në qafë më vutë një kryq teneqeje
dhe në sënduk më vutë një fishek;
o tata im, në Atdheun tonë të lirë,
si natë e zezë, kanuni ty të ndjek.
Nuk fryn shtërngatë tani mbi bjeshkët
tona,
nuk derdhin retë e zeza të verdhin shi:
ne shëmbëm me themel me duart tona
faltore, teqe, kishë dhe xhami.
Me ty po flet kështu sot bija jote
jo më me zërin memec përmbi djep,
as nuk cijas si zoçka nga kuvlia:
guxim e zemër partia më jep.

Dëshirat tona ndizen për çdo ditë,
gëzimet tona rriten mbi trase
po flet me ty sot vullnetarja Mrikë,
po flet me ty kjo hekurudha e re.

Sa shpejt ndryshojnë kohët, tata im!
Lumenjtë e dritës ngjiten mbi malësi,
por prapë themi: ka blozë nëpër mure
dhe prapë themi ka blozë në mushkëri.

U rrita, tatë, në Alpet plot me borë,
ku bjeshkët prekin qiellin me gishtërinj
ku mjekrat tundin pishat degëgjata
dhe gonxhja çan si shpatë mbi shkëmbin.
Dhe ti qëndron i vrejtur dhe i ngrysur.
Ajo fejesë të vjen rrotull si hije
dhe zërin tim dëgjon atje mbi shpatë:
që vjen nga larg si tingull çiftelie.

O tata im,
rrjedh lumi i jetës, rrjedh
dhe hedh mes tij kjo cuca jote shtat,
jo duke ndjekur pyllit shtojzavallet,
as delet porsi gjyshja shpat më shpat.
Gëzohu ti, o tata im, gëzohu! . .

Jam luftëtare, pushkën shtrëngoj ne radhë,
të putha me mall,
gëzohu, pra,
 krenohu
o tata im
i mirë flokëbardhë.

VLORA NUSE, O MOJ VLORA PLAKË

Bisedë me Sh. Derrin

Është i bukur shumë ky qytet.
Më pëlqen të rri këtu përherë,
të sodis përballë plakun det,
të thërres: «E bukura rivierë»;
do të kujtoj mbrëmjet buzë detit,
do të kujtoj plakun peshkatar.
Më ka folur plaku për qytetin,
më ka folur plaku sypishtar:
«Shtatin rrita, djalo, nën ullinj,
portokalleve u kam thithur erë».
Më dëgjon, të flas, bir, për jetën:
e piu deti varfërinë në gojë...
Kam luftuar mbi shkëmbinjt' e vjetër
dhe shkëmbinjtë më ngjajnë si mburojë...

«Fort e hidhur koha e kaluar,
porsi hije e zezë dhe e shkretë,
porsi natë ditët patën shkuar»...
Më tregoka plaku për qytetin,
më tregoka për rininë e tij:
«Ja, atje ku tokën e prek deti,
kam jetuar kur isha i ri.
Ja, atje përmbi atë kthesë,
kur ulliri çel edhe limoni,
e mbi kopshtie ngrihej një ndërtesë,
na e pinte gjakun tonë padroni.
Beu hante pula dhe limona,
ne bukën ngjyenim me shëllirë...
I tmerruar shpesh qyteti zgjohej,
Çdo mëngjez e darkë kish uri.
Bomba, plumba rrugëve fluturonin,
deti ziente bregut nga stuhia,
ziente zjarr i kuq revolucioni.
Nga çdo rrugë dhe në çdo shtëpi
Zjarri digjte, digjte dhe goditte,
shtrinte hasmin mbytur gjak të zi
dhe liria zemrat na i ndizte.

Në qytet më kujtohet nata. . .
Prisnim hënën të dilte nga retë,
të na ndritte si kandili vatrat,
të na ndritte qytetin e shkretë.
Më beso, o bir, kur kishte hënë
arratisnim sadopak mërzitë.
Barku rri një ditë e dy pa ngrënë,
porse syri kërkon diell, dritë.
Më kujtohet populli atëhere,
mijra zëra kushtrimi përhapte,
çante qiellin, hynte thellë në det. . .
Porsi bombë shpërtheu shpirt i detit
dhe gëzimi shpërtheu në qytet.
Vazhdoi lufta, ishte luftë e gjatë.
Kudo ishim ne, kudo luftonim.
Shtigjet skuqnin, toka ndizej flakë.
Ç'të tregoj, fund nuk ka biseda,
valëskuqur derdhej shpejt Shushica,
si orteku zbritte këtej çeta,
si Selami, dikur, nga Babica.
Më kujtohet Teli ra te sheshi.
Ne këndonim «Moj Vlora plakë. . .»

Teli Ndini shumë ty të deshi.
...Plagë mora shumë e u shërova.
Qeribanë me plumba ma vranë;
por fashizmit zemrën ja shpova
për Atdheun, gruan dhe vëllanë;
në qytet prapë shokët takova
edhe detin, që ndizej në flakë,
për lirinë me shokët këndova:
«Vlora nuse, o moj Vlora plakë»!

BISEDË ME USHTARIN E RI FETAH

poemë

E di, Fetah, se je ushtar i ri,
dhe në stërviçje ti e ke vështirë,
marshim të gjatë ende nuk ke bërë
dhe pushkën ende ti nuk e njeh mirë.

Nuk je mësuar me netët ushtarake,
T'i qethën ty dhe kaçurrelat flokë;
dhe të vjen keq e skuqesh bëhesh flakë,
kur në detyrë të kalojnë shokët.

Ti nuk ke hapur transhera me lopatë

dhe as ke ndenjurr gjithë natën pa
gjumë;
veç, po t'u dha alarmi këtë natë,
ti ngjitur çdo mal dhe kapërcen çdo lumë.

Ty do të bjerë të flesh dhe pa kapotë,
dhe të mos kesh të ndezësh një cigare,
por nuk ngrin ushtari kur pranë i ka
shokët,
se zemrat e shokëve ngrohini porsia zjarr.

Ike nga rrjeshti, vajte nën strehë,
po shokët pse qëndruan nën shi?
Sikur dhe predha mbi kokë të të bjerë,
pa urdhër mos hidh hap, ushtar i ri.

Të erdhi keq kur shokët të qortuan,
e ndjeve veten, ushtar i ri, fajtor,
sikur mbi ty dhe malet u rrëzuan,
sikur atdheu thirri «dezertor».

Po ç'bëre ti? I vogël qe gabimi.
Ai largim të preku gjer në gjak,
të thirri ty ndërgjegjja dhe guximi,
të thirri ty betimi ushtarak.

Të shqetësoi sot një kujtim i afërt
kur me ty shokët atje në shesh u
mblodhën. . .

«Shërbim të mbarë» prindët të uruan,
me përqafime të përcollën.

Të përqafuan nëna edhe motra
të puthën buzët e vajzës-mami
dhe sytë e saj në zemër të ndriçuan
dhe ndritën qartë tënden dashuri.

Në fshat me vajzën lidhe dashurinë
e ndriti hëna me bririn magjik
dhe dogji ajo të ligat thashetheme,
shkrumboi vështrimin fanatik.

Këto mendime kujtimi po të ndizte:
bleronte përpara fshati yt i ri
me bukën dhe me këngën socialiste,
te gryka e pushkës-lumturi e tij.

Bleronte përpara gëzimi yt i gjatë,
gëzimi yt mbi krahë të rrëmben
dhe rend mbi ara dhe derdhet përmbi
shatë,
përmbi kalldrëm të fshatit ngazëllen.

Dhe thua ti: «A s'jam një bir fshatari
që kam lëruar, kam korrur dhe kam
shirë,
që kritikoj, bile dhe kryetarin,
kur punët nuk na shkonin mirë?»

Dhe thua ti: «A nuk jam ai djalë,
që çova zërin tim në komitet,

që thirra: «Duhet punë e jo fjalë;
të ngrehim kinema si në qytet?»

Dhe thua: «Fjeta netve nën vesë,
edhe shihja lumturinë e fshatit,
pastaj luftoja me mblesë dhe me shkesë;
me mykurinë e burokratit».

Dhe thua ti: «A nuk jam ai djalë,
që hapja pozicionin si me plor
e thoshin pleqtë: «Ky gjak të merr në
ballë?»
Tani ushtar e paskam kaqë zor?».

Të erdhi rëndë aty te vija e zjarrit,
kur t'u kujtua të ngrohtit në shtëpi
dhe the: «E rreptë detyra e ushtarit,
ashtu e rreptë si ti, o moj liri».

II

«Ushtar Fetahu, më shpejt armën e
mbush,
më shpejt «armikun» në grackë e zë».
Kjo fjalë ty në zemër të ndez prush
dhe gishtin ti në këmbëz shpejt e vë.

E vë e kujton Kiçokun, Drashovicën,
si ndezej rreptë sulmi partizan,
në zemër ndjen si shkrepje një trokitje,
kur shenjën ti me plumb më dysh e
ndan.

Të ndriti ty në sy urimi i parë:
«Të bësh më shumë» detyra të tha,
«Kështu ti qofsh, i shpejtë porsi plumbi,
i zjarhtë porsi zjarri, o vëlla».

III

Me ty u mblodhën shokët në betim;
aty lexuan me zjarr urdhrin epror.
T'u ndezën sytë si yje plot shkëlqim,
t'u ndez betimi i rreptë në krahor.

E tok ti me komandantin tënd:
si zemër e tij e ngrohtë, dora e tij;
të mbeti në zemër, të mbeti dhe në
mend
ai urim: «Ushtarë, bijtë e mi. . .»

Të mbeti në zemër i thjeshti komandant,
me ty jeton, stërvitet për çdo ditë,
më pranë e ke, kur ngjitesh majës lart
dhe kur hap zjarr mbi shenjë dhe mbi
pritë.

Ushtari i ri, o shoku ynë Fetah,
këtu atdheu të gjithëve na bashkon.
Pastrim i bëjmë ndërgjegjes, o vëlla,
ndërgjegje e pastër grushtin na forcon.

Këtu ne jemi vëllezër të pandarë;
nuk ngjan eprori i madh porsi një mal;
një për të gjithë, kuadro dhe ushtarë,
atdheu është më i madhi gjeneral.

Ty shokët nuk të ndajnë nga gëzimet.
Këtu miqësia rrënjët thellë shtrin,
e pastër rrjedh si uji nga burimet
dhe si pranvera akujt ajo shkrin.

IV

Gjëmojnë mitralozët si rrufetë.
Ushtar Fetahu mbushet me gëzim,
kur sheh si predhat copëtojnë retë,
kur sheh si ndizet ashpër ky luftim.

E di, Fetah, do ecësh nëpër natë,
do flesh mbi borën e butë si qilim,
do çash transhe në shi dhe në
shtrëngatë,
do shkrepësh armët pa pushim;

do shkrepësh topat radhë,
kur të buçasë urdhëri luftarak.
Fitorja do të çelë kaq e bardhë
dhe ëndrrat do të çelin mbi zëmbak.

Qëlllo me zjarr, copëto me bajonetë,
mbi agresorët egër u vërvit,
stërvitu, shok, dërsi nën helmetë,
me zjarr e flakë kodrën lart ngjit.

Këtë atdheu nga ti e kërkon,
e do e shenjta liri e tij.
Në qoftë se plumbi zemrën ta shpon,
ti pa ngurrim jetën bëje fli.

Ushtar i ri, shtëpitë para teje,
fabrikat dhe burimet ujëftohta
ti do t'i mbrosh me gjak në çdo betejë,
ushtar i ri i veshur me kapotë!

NE DHE TOKA

(poemë)

Në luftë u përtëritëm ne,
në zjarr u përtëritëm,
urrejtjes nuk i vumë fre
duke kërkuar dritën.

Ndëshkuam ata që gjak na pinë,
ata që vranë ëndrra e dogjën tokë,
ata që, porsì minj, kërkonin vrimë
të mund të futnin kokën.

Dhe s'falëm ne kërkënd:
në tribunal hakmarrja shpatën ngriti;
pastruam tokën nga çdo gjëmb,
mendimi i kuq çdo gjëmb e zhuriti.

21

Atdheu mëkëmbej.

Rruga s'ishte e lehtë,

megjithëkëtë ditët gdhiheshin më të

mira;

me këngë, me parmendë e bajonetë

luftonim. S'prapsej lehtë errësira.

Dhe plagët e atdheut po shëronim

me bukë pak e duar të vrara

dhe historinë e kohëve të reja

me gjoksin tonë e shtymë më përpara;

pastronim tokën edhe qiellin

të përçafonim diellin.

Shqipëria pak flinte në ato net

vrojtonte para-prapa

dhe hidhte hapat shpejt.

Një zë si mijëra vetëtima ndriti

duke na ngrohur zemrat një për një,

Partia dorën më lart e ngriti:

reformë e parë për ty, Shqipëri.
Reformë e parë —
ëndërr e vjetër
gatuar me gjak e djersë arë më arë,
një ëndërr që përloti
dhe bujkun dhe parmendën dhe sqeparë,
që jetonte
ngarkuar shpesh me krisma e
shqetësime
dhe që lëvizte ditë e natë
mbi brazda e fusha, ara, e burime.
Reformë e parë, një ëndërrim i gjatë,
që po varroste brenga dhe mundime,
reformë e parë...
Enveri dorën zgjati
tapinë e tokës të varfërve ju dha.
Dëshira stërgjyshore arat mati
pas luftrash e gjakderdhjesh të mëdha.



Fshatar,
të rrahën kohërat keq si me tokmak,

të rrahën gjoksin tënd,
nga shtypja shpesh pështyje gjak;
të shtrydhën ty mbi një rrip vend.
I kërrusur stoikisht mbi një grusht dhe,
ti pushkën e parmendën nuk i le.
Fshatar,
e ç'ishte toka për ty?
Ishte perëndi, më e larta perëndi.
Për të ti verbërisht u fale
në kishë e në xhami.
Ishte ngatërruar keq besimi yt
për tokën dhe për zotin.
Me vdekjen ti u hëngre fyt për fyt,
ndërsa tjetërkush ta thithte
gjithë djersën, gjakun, lotin...
Dhe ëndërrove një rrip tokë
që me thonj do ta lëroje,
me gjak do ta vaditje,
që një grusht misër të prodhoje,
që këmbëzbathurit të rritje.
Dhe ti, fshatar, e pe.
— e pashë dhe unë —

se si ta zgjati dorën në furtunë,
se si të tha:
Mbështetu fort pas meje,
shok armësh dhe beteje;
se si të priu në rrugën madhështore
solidja klasë punëtore.
Partia e saj, partia jote
të ngriti në pedestal të kësaj bote.
Dhe rrjedhin ditë e muaj e vite
dhe rrugën e bashkimit fshati merr,
kooperativë e parë shpejt u ngrit.
Kulaku prapa shpine villte vrer;
armiku thurte plane e priste
të ngjallte prapë atë që vramë ne.
Por nata diellin dot s'e vriste...
sa na mësoi në çaste më të rënda,
partia jonë,
dielli ynë,
ta mbanim dorën te parmenda,
ta mbanim në shinjestër synë.
Dhe, ndonëse në ndërgjegjet tona
ngatërroheshin paragjykimi e prona,

filloi të mbinte fara e ëndërruar,
 ndriçonte shpresa shekullore,
 fshatari duart kishte shtrënguar
 me të çeliktën klasë punëtore.



Ne mbollëm tokën me që, shat e kuaj;
 parulla ngjitëm shpesh dhe në tevlík;
 qëlluam çdo mendim të huaj
 me plumb e me kamxhík;
 qëlluam mosbesimin që thosh: «bah,
 si do t'ja bëjmë hallit?
 po nuk kërkuam ndihmë, mor vëlla,
 do hamë lakra, bar».
 E tmerrshme kjo përrallë,
 sërish të bëhej populli lypsar!
 Çfarë cektësi mendimi prej borgjezi,
 kulakun deshi ta bënte zot në fshat!
 Por zjarri që partia ndezi,
 e bëri shkrumb çdo renegat.
 Dhe shtohet bereqeti për çdo vit,

kallinjtë vërshëllejnë porsi zogj.
Ne themi: «Lavdi klasës që u rrit».
Ne themi: «Lavdi grurit që u poq».
Dhe derdhet gruri ndër lëmenj
dhe hidhet misri në hambar
dhe vendi ndrit nga zjarret e mëdha,
që ndez mendimi ynë proletar.
Në gji të tokës kokën e mbështet,
nga toka bukë e forcë marr,
kokën e kam një copë plis
të ngjitur në ugar
dhe trupin lis
të rritur në korie.
Ndaj erë grurë e misër unë bie.
Mjeshtër të tokës kush më bëri vallë?
Babai dhe toka.
Toka më tha: «Jam buka»,
babai më tha: «Punoje»
dhe si cep plugu gishtërinjtë në tokë
futa,
dheun thërmoj, dheun spërkas;
dhe shkallë drithrash ngjit më lart.

Ne flakim tej çdo zakon të vjetër;
me ashpërsinë e malit jemi mbrujtur,
edhe kur kemi veshur veç një setër,
pas vatrës dhe mangallit s'jemi futur.
Përjetësisht me tokën jemi lidhur
dhe nuk na mposhtin dot kurrë!
Më lart e ngrehim flamurë!

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|--|----|
| Rapsodi aksionesh | 3 |
| Lulet | 5 |
| Biri im | 7 |
| Të gjitha... .. | 8 |
| Të katër | 9 |
| Erdhën djemtë nga ushtria | 11 |
| Ushtar | 13 |
| Të gjitha rrugët më sjellin tek ti | 15 |
| Dhe në det i ka shqipet Republika | 17 |
| Ç'pashë sot te ushtarët | 18 |
| Motra | 19 |
| Kritikë për shokun Aliko | 20 |
| Ej, moj Fato | 22 |
| Dëshmorit Baki Dume | 27 |
| Shkuam të korrnim grurë me fshatarët | 29 |
| Këngë për Selim Hasanin | 30 |
| Kuvendoj me nënën | 32 |
| Peisazh vjeshte | 34 |
| Që nga kohërat zëra lufte vijnë | 36 |
| Monologu i një zezaku | 37 |
| Letër tatës | 39 |
| Vlora nuse, o moj Vlora plakë. | 43 |
| Bisedë me ushtarin e ri Fetah (poemë) .. | 47 |
| Ne dhe toka (poemë) | 57 |

57524

BIBLIOTEKA E SHITETIT
GJIROKASTER

Tir 1.000 kopje Format 60x88/32 Stash 2204-65

Shtypur në NISH Shtypshkronjave «Mihal Duri»

Stabilimenti «8 Nëntori» Tiranë, 1972